



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 16-9722/2016
Kaçanik, 29.04.2016

Në bazë të nenit 12, 17(e) të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), të nenit 6 lidhur me nenin 34.5 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe Rekomandimit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 prill 2016, merr këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS TRUNGJEVE TË DUSHKUT (*Quercus sp.*) DHE QARRIT (*quercus cerris*) NË RUNJEVË SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës dy **Trungje të dushkut** (*Quercus sp.*) dhe një trung i qarrit në fshatin Runjevë, Komuna e Kaçanikut si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
 - 1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5m rreth projeksonit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej **3 ari**.
 - 1.2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Kaçanikut. Perimetri i tyre sillet nga mes 4-4.50m, diametri i kurorës është 14-25m. Njëri nga trungjet nuk është në gjendje të mirë ngase ka filluar tharja e kurorës së tij, kurse dy trungjet tjera janë në gjendje të mirë. Moshja e trungjeve sillet rreth 250 vite.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit Runjevë, konkretisht në lagjen Burrniku, në lartasin mbidetare 506m, Zona Kadastrale Runjevë, parcela nr. 419-0 dhe 420-0, me sipërfaqe 1279m² dhe 4074m², koordinatat LONG: 42.44353, LONG:21.253239, P.SH. Kuvendi Komunal Kaçanik, me kulturë varreza.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III - të, Natural Monument / Natural Landmark - Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
 - 4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
 - 4.1.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,
 - 4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,
4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

4.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

4.2.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

5. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

5.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,

5.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,

5.3. Ndërrimi i kulturës,

5.4. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

5.4.1. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Kaçanikut.

6.1. Kujdestari është i detyruar:

6.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,

6.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

6.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

8. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

9. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i mëhershëm 01. nr. 16-30571/15, i datës 29.09.2015.

